

V E N D I M
Nr. 78, datë 6.2.2003

**PËR MIRATIMIN E STEMËS, TË UNIFORMËS DHE TË NORMATIVAVE TË
VESHMBATHJES PËR POLICINË E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 6 të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e uniformës për personelin drejtues (oficer) dhe për personelin operues (polic zjarrfikës), si dhe të normave të veshmbathjes, përkatësisht, sipas lidhjeve nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Miratimin e stemës së PMNZSH-së sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe prefektët e qarqeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.2

Norma e veshmbathjes për oficerët e PMNZSH-së

Nr	Artikujt	Sasia	Vite	Ngjyra
1	Xhup shevro	1	4	E zezë
2	Xhup trikon	1	3	Blu e errët
3	Kostum stof me përzierje (xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 kapele)	1	2	Blu e errët
4	Pantallona vere	2	2	Blu e errët
5	Pulovër	1	2	Blu e errët
6	Këmishë me mëngë të gjata	2	1	E bardhë
7	Këmishë me mëngë të shkurtëra	2	1	E bardhë
8	Bluza me mëngë të gjata	2	1	Blu e errët
9	Bluza me mëngë të shkurtra	2	1	Blu e errët
10	Këpucë gjysma, lëkure, verore	1	1	Të zeza
11	Këpucë gjysma, lëkure, dimërore	1	1	Të zeza
12	Rrip pantallonash	1	2	I zi
13	Gravatë	2	3	Blu e errët
14	Doreza lëkure	1	4	Të zeza
15	Çorape	4	1	Të zeza
16	Këpucë me qafa	1	2	Të zeza
17	Kostum doku për stërvitje	1	5	Blu e errët
18	Rrip sigurimi	1	5	
19	Grada	2	2	Blu e errët
20	Uniformë speciale kundër zjarrit	1	Pa afat	

Lidhja nr.2

Norma e veshmbathjes për personelin operues (policë zjarrfikës)

Nr	Artikujt	Sasia	Vite	Ngjyra
1	Xhup trikoton	1	3	Blu e errët
	Kostum pune vere, dok trikoton (xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 kapele)	1	1	Blu e errët
3	Kostum pune dimri, dok trikoton (xhakëtë, 2 palë pantallona, 2 kapele)	1	1	Blu e errët
4	Pantallona vere	2	2	Blu e errët
5	Pulovër	1	2	Blu e errët
6	Këmishë me mëngë të gjata (jakë sportive)	2	1	E bardhë
7	Këmishë me mëngë të shkurtëra (jakë sportive)	2	1	E bardhë
8	Bluza me mëngë të gjata	2	1	Blu e errët
9	Bluza me mëngë të shkurtra	2	1	Blu e errët
10	Këpucë gjysma, lëkure, verore	1	1	Të zeza
11	Këpucë gjysma, lëkurë, dimërore	1	1	Të zeza
12	Rrip pantallonash	1	2	I zi
13	Çorape	4	1	Të zeza
14	Këpucë me qafa (zjarrfikëse)	1	2	Të zeza
15	Rrip sigurimi	1	5	
16	Grada	2	2	Blu
17	Uniformë speciale kundër zjarrit	1	Pa afat	



Lidhja nr.3

Stema e vendosur ne krahun e majte.



Pjese perberse e stemes, vendosur
ne jakat e xhaketes dhe kemishes.